



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës



RAPORTI VJETOR 2023



Inspektorati Policor i Kosovës

©Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (Inspektoratit Policor të Kosovës) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet. Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,

Rruga “Dëshmorët e Gollakut”,p.n, Hajvali, Prishtinë,

Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201

E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

inspektoratipolicor@gmail.com

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AMP	Agjencia për Mbikëqyrje Policore
DBI	Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim
DPBÇLI	Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DI	Departamenti i Inspektimeve
DMA	Departamenti për Menaxhimin e Ankesave
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRK	Drejtoria Rajonale Kufitare
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DH	Departamenti i Hetimeve (IPK)
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të Kaluarës
EPAC	European Partners Against Corruption
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KBD	Komisioni i Brendshëm Disiplinor
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJKA	Njësia e Kontrollit të Autostradave
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PPKK	Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit
TI	Teknologjia Informativë
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

PËRMBAJTJA

1.	RRETH NESH	5
2.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	6
3.	HYRJE.....	7
4.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
5.	MENAXHIMI I ANKESAVE	9-15
6.	HETIMET PENALE	16-27
7.	INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE	28-38
8.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI	39-45
9.	SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE.....	46-50

1. RRETH NESH

Historik i shkurtër

IPK është mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, i pavarur nga Policia e Kosovës dhe funksionon sipas modelit të vendeve perëndimore që aplikojnë standarde të larta ndërkombëtare të kontrollit policor dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Është themeluar në korrik të vitit 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2005/54 dhe Urdhëresës Administrative nr.2006/9, si Agjenci Ekzekutive në kuadër të MPB-së. Bazuar në këto akte, ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 për IPK-në, të miratuar në vitin 2008. Më pas, për shkak të ndryshimit të mandatit ligjor në fushën e hetimeve, nga viti 2010, IPK-ja funksionon bazuar në Ligjin nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.

Fushëveprimi

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe

zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

4. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizon Inspektoratin Policor të Kosovës për zhvillim të hetimeve disiplinore. Inspektorati Policor i Kosovës pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

5. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

Misioni

Misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Vizioni

IPK synon fuqizimin e rolit të tij në funksion të rritjes së integritetit, profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale dhe etike për qytetarët.

Parimet tona

Si një agjenci e përkushtuar për t'iu shërbyer interesave të të gjithë qytetarëve, IPK-ja udhëhiqet nga vlerat, si: përgjegjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti.

2. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Të jesh një organizatë e suksesshme në përmbushjen e misionit, nuk mjafton të kesh vetëm kompetencë, por edhe përkushtim të vazhdueshëm në realizimin e objektivave të vëna. Në këtë mënyrë, sukseset edhe arritjet e organizatës përmbushin pritjet që kanë qytetarët, Qeveria dhe partnerët, të cilët duke i besuar dhe mbështetur organizatën, shohin qëndrueshmëri në rrugëtimin për zhvillim të vazhdueshëm institucional. IPK po vazhdon të jetë institucion i besueshëm në përmbushjen e misionit për të siguruar një polici të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale. Edhe viti që lëmë pas ka pasqyruar përkushtimin dhe dedikimin e secilit punonjës për të rrugëtuar sigurt në arritjen e objektivave tona, vlera këto që shtyjnë zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe organizativ të agjencisë tonë.



Kryeshefi Ekzekutiv Kushtrim HODAJ

Viti 2023 mbetet një vit i suksesshëm në përmbushje të mandateve tona dhe kjo falë bashkëpunimit të qytetarëve për të adresuar shqetësimet e tyre, përkrahjes së vazhdueshme që ofrojnë partnerët, por edhe falë angazhimit të të gjithë punonjësve të IPK-së, gjëra për të cilat edhe iu jam mirënjohës. Është bërë punë e duhur në adresimin e shqetësimeve të qytetarëve përmes ankesave të tyre, janë ndërmarrë aktivitete pro-aktive në përmirësimin e shërbimeve të policimit përmes inspektimeve në rritje, si dhe aktivitete reaktive në hetimin e veprave penale nën dyshimin se punonjës policor mund të jenë përfshirë në to. Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë një nga prioritetet tona, drejt fuqizimit të një policie me integritet.

Efektivitetin, efikasitetin dhe profesionalizimin e IPK-së në luftimin e krimit dhe keq-menaxhimit vazhdojnë ta vlerësojnë shumë akterë, përfshirë këtu institucione, organizata të shoqërisë civile, partnerët dhe qytetarët. Në një ceremoni zyrtare, Departamenti i Shtetit Amerikan ka renditur IPK-në në krye të institucioneve ligj zbatuese sa i përket luftimit të krimit dhe korrupsionit. Vlerësime të tilla na inkurajojnë që të ecim para, drejt krijimit të një ambienti edhe më të sigurt për qytetarët.

Bashkëpunimi vendor, rajonal dhe ndërkombëtar me institucione dhe agjencitë homologe ka qenë pjesë e agjendës tonë dhe viti 2023 reflekton në një sërë angazhimesh. Falë kontributit tonë dhe përkrahjes së partnerëve u mundësua krijimi i një mekanizmi të përbashkët me vende të rajonit, në luftimin e krimit ndër-kufitar dhe IPK ka një rol prijës në nismën për funksionalizimin e Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore.

I gjithë ky potencial angazhimesh dhe suksesesh nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen edhe të partnerëve tanë, përfshirë ICITAP-in, OSBE-në, MPB-në, të cilët ndihmuan IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. IPK është e vetëdijshme për këtë rol dhe kontribut, andaj edhe i është falënderues secilit prej tyre.

Në fund, IPK zotohet se do të vazhdoj të jetë dhe më tej e përkushtuar për të përmbushur në mënyrë profesionale dhe transparente, detyrat dhe përgjegjësitë ligjore, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë qytetarët dhe institucionet tjera kompetente.

3. HYRJE

Ky është Raport përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën janar - dhjetor 2023, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti pasqyron sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

Në drejtim të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të informacionit për qytetarët mbi punën që bëjmë, IPK-ja praktikon që të publikojë një dokument përmbledhës në standardin e një Raporti të rregullt vjetor, ku pasqyrohen sfidat dhe angazhimet tona në përmbushje të përgjegjësive dhe misionit ligjor.

IPK vlerëson se nga viti në vit puna jonë vazhdon të jetë më cilësore dhe këtë e dëshmojnë rezultatet tejet mbresëlënëse. Rezultatet konsiderohen se janë të përbashkëta, ngase pjesë të suksesit tonë bartin dhe qytetarët që ofruan një bashkëpunim në denoncimin e shkeljeve nga radhët policore, por edhe partnerët tanë që na mbështetën në këtë rrugëtim.

Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me funksionet e saj, IPK i ka të ndara në departamente. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për punonjësit e IPK-së, agjencia jonë është e strukturuar në pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës. Roli i secilit departament është i shtjelluar në brendësi të këtij Raporti.

Raporti i këtij viti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e departamenteve, rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve duke përfshirë krahasimin e trendëve të rasteve ndër vite, mënyrën e trajtimit të ankesave, ngarkesën ndër muaj, etj.

Përveç tjerash Raporti ynë ofron informacione shtesë edhe për disa aktivitete të rëndësishme të IPK-së gjatë vitit 2023, si përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv në Washington si fitues i çmimit kryesor për Sukses të Jashtëzakonshëm Operacional për ditën e Akademisë Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit (ILEA), përmbledhje për punëtoritë që kanë mbledhë së bashku bashkëpunëtorë policor dhe prokurorë për të diskutuar konceptin e përdorimit të forcës proporcionale dhe autorizimet policore, organizimin në Prizren të Konferencës Rajonale tre ditore me temën “Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit në policinë kufitare”, nënshkrimin e Deklaratës për themelimin e Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore etj.

IPK-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit, në përmbushje të mandateve që dalin nga Ligji për IPK-në, në drejtim të sigurimit që Policia e vendit tonë të zhvillohet si forcë e përgjegjshme, profesionale dhe demokratike. Ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, andaj dhe interesi ynë është që Policia të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Në përfundim të kësaj hyrjeje, vlerësojmë se edhe pse kemi ofruar disa dritare të informimit të qytetarëve mbi angazhimet tona, ne zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë t’iu ofrojmë informacionin me kohë dhe për kureshtjen tuaj, siç vazhdon të jetë edhe kjo praktikë e raportimit e shprehur përmes këtij Raporti.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë përmbledhje janë pasqyruar informata të dala nga analizat e kryera mbi performancën e organizatës në të gjitha drejtimet, bazuar në mandatet e përcaktuara me Ligjin për IPK-në.

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **1697** ankesa, të pranuar në mënyra të ndryshme;
- **32%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **68%** i kemi orientuar për hetim disiplinor Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq-menaxhimit policor:

- Kemi hetuar **178** të dyshuar (156 punonjës policorë dhe 22 qytetarë);
- Kemi ngritur **74** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **35** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **71** punonjësve policorë.

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam trembëdhjetë (**13**) inspektive të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtjesore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam **qindra** dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj., dhe realizuam dhjetëra intervista;
- Rekomanduam avancimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së **126** rekomandimeve;
- Verifikuam përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve dhe transparencës për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi **60** komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi **180** kërkesa të tyre;
- Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj.;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore.

5. MENAXHIMI I ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave (tutje si DMA) është ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së, që ka për objekt të veprimtarisë: pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin, se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë apo institucioneve përgjegjëse¹.

Qytetarët e vendit dhe ata të huaj mund të paraqesin ankesë në DMA lidhur me pretendimet e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e Policisë ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat e sjelljes.

Ankesë konsiderohet çdo parashtresë e drejtuar në IPK nga ndonjë individ ose grup i interesit, me të cilën shprehen shqetësimet lidhur me sjelljen devijante të punonjësve policorë apo kur parashtresa ka të bëjë me standardet policore apo udhëzimet operative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DMA-së janë:

- të sigurojë realizimin e politikave e procedurave të organizatës në menaxhimin e ankesave dhe të informacionit të disponueshëm mbi dyshimet për përfshirje të punonjësve të Policisë në vepra të kundërligjshme;
- të sigurojë mbajtjen e evidencave/regjistrave për ankesat dhe mbi bazën e tyre nxjerrë statistika me të dhëna për raportime;
- të sigurojë që informatat që posedon IPK-ja mbahen/ruhen sipas ligjeve përkatëse;
- të sigurojë që ankesat trajtohen duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin e IPK-së².

¹ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

² Neni 15 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017

DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E ANKESAVE

- Trajtuar 1697 ankesa dhe informacione të ndryshme;
- 540 ankesa i kualifikuam si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale dhe i proceduam në Departamentin e Hetimeve të IPK-së;
- 1.145 ankesa i kualifikuam se përmbajnë elemente të shkeljeve disiplinore, dhe i proceduam në Divizionin e Hetimeve të Brendshme në kuadër të Policisë së Kosovës.

Bazuar në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, DMA-ja përbëhet nga dy divizione:

- Divizioni i Trajtimit të Ankesave;
- Divizioni i Administrimit të Lëndëve,

DMA ka të punësuar tetë (8) punonjës.

(Departamenti i Menaxhimit të Ankesave).

Faktet kyçe (indiktorët):



Mënyrat e ankimit



Me postë
8.7%



Përmes policisë
15.4%



Fizikisht
29.9%



Me email
36.7%



Tjera
9.3%

Gjinia e ankuesve

Meshkuj (79.9%)



Femra (12.3%)



E panjohur (7.8%)



Etnia e ankuesve

Shqiptar

88.6%

Pakica

3.6%

E panjohur

7.8%

Kualifikimi

Vepra penale (31.8%)



Shkelje disiplinore (67.5%)




Tjera (0.7%)



Pranimi i ankesave

DMA gjatë vitit 2023 ka administruar gjithsej 1.697 ankesa të natyrave të ndryshme. Krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë se ka pasur një numër të njëjtë, ndërsa krahasuar me vitin 2021 (vit i pandemisë) kemi trend të uljes së numrit të ankesave. Rezultatet pasqyrojnë se vazhdon trendi i besimit të qytetarëve tek institucioni ynë. Kjo performancë rezultojnë si rezultat i punës që bëjnë punonjësit e IPK-së, qoftë në rrafshin e përmbushjes së mandateve dhe promovimin e vlerave dhe sensibilizimin qytetar.



Mënyrat e pranimit të ankesave

Sipas akteve ligjore e nënligjore të IPK-së, qytetarët kanë mundësi të ndryshme që të procedojnë ankesat e tyre. Nëse i referohemi statistikave të viteve të fundit, shihet se edhe këtë vit qytetarët më së shumti kanë preferuar që ankesat e tyre t'i dorëzojnë përmes postës elektronike, për shkak edhe të përdorimit gjithnjë e më shumë të teknologjisë informative. Dorëzimi i ankesave fizikisht në IPK si dhe dorëzimi përmes postës, po ashtu janë ndër mënyrat më të shpeshta që preferojnë qytetarët.

Tabela nr. 1-Të dhëna përmbledhëse mbi numrin e ankesave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre

Nr.	Mënyrat e parashtrimit të ankesave në IPK	Numri	Përqindja
1	Ankesa të pranuar në formë elektronike	623	36.71
2	Ankesat e pranuar fizikisht në IPK dhe zyrat rajonale	508	29.94
3	Ankesa të pranuar përmes postës	130	7.66
4	Ankesa (inicime) nga Departamenti Hetimeve	147	8.66
5	Inicime nga DMA	2	0.12
6	Ankesa të pranuar përmes institucioneve tjera	27	1.59
7	Ankesa të pranuar përmes Policisë së Kosovës	198	11.67
8	Inicime të brendshme nga Policia e Kosovës	62	3.65
	Gjithsej	1697	100.00

Bazuar në të dhënat nga tabela më lartë, del se 1410 ankesa (83.1%) janë pranuar nga mënyrat që ofron IPK (renditja sipas numrave rendor 1, 2, 3, 4 dhe 5), derisa përmes Policisë së Kosovës janë pranuar 198 ankesa (11.7%) dhe 62 inicime të brendshme (3.7%), kurse 27 raste apo (1.6%) janë pranuar nga institucioneve tjera. Ankesa të pranuar nga zyrat rajonale të IPK-së janë si vijon: 27 ankesa të pranuar në Gjilan, 22 ankesa të pranuar në Prizren dhe 2 ankesa të pranuar në Mitrovicë Veriu, në total 51 ankesa.

Kualifikimi i ankesave


Gjatë vitit 2023, 540 ankesa (31.8% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në IPK) janë kualifikuar si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale. Këto ankesa janë proceduar në Departamentin e Hetimeve (D.H) të IPK-së për trajtim/hetim të mëtejshëm.

Numri prej 1.145 ankesave (67.5 % e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në IPK) janë kualifikuar se përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në shkelje disiplinore, dhe të njëjtat janë proceduar në Divizionin e Hetimeve të Brendshme në kuadër të Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti janë evidentuar tri (3) raste (0.2%) që janë proceduar në D.H për t'u trajtuar për shkelje disiplinore në përputhje me mandatin ligjor, një (1) rast është proceduar në Departamentin e Inspektiveve dhe tetë (8) raste tjera (0.5%) janë proceduar në institucionet tjera përgjegjëse.

Sipas analizave të bëra, afërsisht 1/3 e ankesave të pranuar janë kualifikuar se përmbajnë elemente të veprave penale, derisa 2/3 e ankesave janë kualifikuar se përmbajnë elemente të shkeljeve disiplinore (shih diagramin nr.2 si më poshtë).

Në lidhje me ankesat e kualifikuara si shkelje disiplinore, janë dërguar 1.145 njoftime zyrtare me shkrim për qytetarët për t'u njoftuar se ankesa e tyre është dërguar për hetim të mëtutjeshëm tek autoriteti kompetent në kuadër të Policisë së Kosovës.



Përkatësia gjinore e ankuesve

Sipas të dhënave të DMA-së, në vitin 2023, gjithsej 1.356 ankesa janë adresuar nga persona të gjinisë mashkullore, derisa 208 ankesa janë adresuar nga persona të gjinisë femërore. Për pjesën e mbetur prej 133 ankesave, nuk ka qenë e mundur të dihet gjinia, për shkak të mënyrës që është përzgjedhur të ushtrohet ankesa dhe këtu hyjnë inicimet zyrtare nga DMA-ja, inicimet e brendshme, ankesat anonime dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera.

DMA është interesuar të njihet me faktin se sa ka ndërruar raporti gjinor sa i përket personave që kanë adresuar ankesa në IPK ku kemi këto rezultate (shih tabelën nr. 2).

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2021	%	2022	%	2023	%
1	Meshkuj	1.603	79.6	1.351	79.6	1356	79.9
2	Femra	233	11.6	211	12.4	208	12.3
3	E panjohur	177	8.8	135	8	133	7.8
	Gjithsej	2.013	100	1.697	100	1.697	100

Përkatësia etnike e ankuesve

Në vitin 2023, gjithsej 1.504 ankesa janë adresuar nga persona të përkatësisë shqiptare, 52 prej tyre nga persona të përkatësisë serbe, 6 nga persona të përkatësisë boshnjake dhe 2 të tjera nga shtetas të huaj. Në totalin prej 1.697 ankesave, për 133 ankesat e pranuar në IPK, nuk dihet përkatësia e ankuesve, meqë lidhen me inicime zyrtare nga DMA, iniciimet e brendshme, ankesat anonime, si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucione tjera. Po ashtu, DMA është interesuar të njihet me faktin se sa ka ndërruar raporti etnik sa i përket personave që kanë adresuar ankesa në IPK. Bazuar në dhënat tona zyrtare, IPK-ja gëzon besueshmëri tek të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Me këtë rast, janë analizuar - krahasuar edhe trendët mbi raportin në mes të personave sipas etnive që kanë ushtruar ankesa në IPK për tre (3) vitet e fundit (shih tabelën nr. 3).

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2021	%	2022	%	2023	%
1	Shqiptar	1748	86.8	1481	87.3	1504	88.6
2	Serb	74	3.7	71	4.2	52	3.1
3	Turq	0	0.0	0	/	0	/
4	Boshnjak	10	0.5	8	0.5	6	0.4
5	RAE	0	0.0	0	/	0	/
6	Të tjerë të huaj	4	0.2	2	0.1	2	0.1
7	E panjohur	177	8.8	135	8	133	7.8
	Gjithsej	2013	100	1697	100	1697	100

Ngarkesa mujore me ankesa

Muaji më i ngarkuar me numër të ankesave përgjatë vitit 2023 ka qenë muaji gusht, ku janë regjistruar 201 ankesa (11.8 % e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar gjatë vitit). Muaji prill ka qenë me më së paku nga të gjithë muajt tjerë i ngarkuar me ankesa të pranuar (92 ankesa apo 5.4% e numrit të përgjithshëm të ankesave).

Nr.	Muaji	2021	%	2022	%	2023	%
1	Janar	137	6.8	124	7.3	98	5.8
2	Shkurt	127	6.3	149	8.8	126	7.4
3	Mars	158	7.8	168	9.9	119	7.0
4	Prill	166	8.2	128	7.5	92	5.4
5	Maj	148	7.4	138	8.1	144	8.5
6	Qershor	187	9.3	174	10.3	143	8.3
7	Korrik	188	9.3	126	7.4	156	9.2
8	Gusht	179	8.9	170	10.0	201	11.8
9	Shtator	274	13.6	128	7.5	185	10.9
10	Tetor	131	6.5	115	6.8	168	9.9
11	Nëntor	167	8.3	133	7.8	128	7.5
12	Dhjetor	151	7.5	144	8.5	137	8.1
	Gjithsej	2013	100	1697	100	1697	100

Numri i ankesave në raport me drejtoritë rajonale

Të dhënat e administruara nga Divizioni i Administrimit të Lëndëve i DMA-së mundësojnë të kuptojmë edhe drejtoritë policore për punonjësit e të cilave ka pasur ankesa të qytetarëve. Sipas të dhënave, ankesat më të shumta janë adresuar për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe arrijnë në 45.2 % të numrit të përgjithshëm të ankesave (shih tabelën nr. 5).

Nr.	Drejtoritë	Numri	%
1	DRP - Prishtinë	769	45.2
2	DRP - Pejë	144	9.1
3	DRP - Ferizaj	165	9.4
4	DRP - Prizren	170	8.0
5	DRP - Gjilan	151	9.5
6	DRP - Mitrovicë Jugu	130	8.0
7	DRP - Mitrovicë Veriu	29	3.5
8	DRP - Gjakovë	110	5.8
9	DRPK - Veriu	8	0.6
10	DRPK - Lindja	14	0.6
11	DRPK - Perëndimi	7	0.4
12	I pa lokalizuar	0	0
	Gjithsej	1697	100

6. HETIMET PENALE

Departamenti i Hetimeve (D.H) është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është:

- Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
- Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë;
- Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutive etj.³

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë:

- kryen hetime penale si dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë, zbaton masat e fshehta hetimore në funksion të fushëveprimit, të autorizuara nga autoriteti kompetent;
- zbaton metoda apo teknika të ligjshme për të zhvilluar kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit, në kuadër të standardeve të larta profesionale policore;
- bashkëpunon me Prokurorinë në fushën e hetimeve dhe shfrytëzon burime të ligjshme të informacionit për nevoja operative;
- nxjerrë raporte mbi rrjedhën e hetimeve të zhvilluara dhe kallëzime penale, ndërmerr veprime të nevojshme ligjore për të siguruar dhe vlerësuar informatat inteligjente.
- siguron mbështetje teknike në funksion të hetimeve (përdorë pajisje teknike në funksion të realizimit të masave të veçanta, siguron dhe trajton dëshmi nga vendngjarja)⁴.

Hetuesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre në tetë (8) divizione. Departamenti ka të punësuar 41 punonjës (Udhëheqës i Departamentit, udhëheqës të divizioneve dhe hetues).

DEPARTAMENTI I HETIMEVE


Departamenti i Hetimeve u angazhuan në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keqmenaxhimit policor:

- Kemi hetuar 156 punonjës policorë dhe 22 qytetarë;
- Kemi ngritur 74 kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar 35 punonjës dhe qytetarë me dyshimin për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme;
- Kemi rekomanduar suspendimin e 71 punonjësve policorë.

³ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁴ Neni 6 i Rregullores (MPB) nr.01/2017 (Departamenti i Hetimeve).

Raporti përmbledhës për hetimet përmban aktivitete të realizuara në suaza të detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga dispozitat e përcaktuara në Ligjin për IPK, në veçanti për D.H dhe të dhënat e gjeneruara që posedon DH. Bazuar në të dhënat nga evidencat zyrtare, gjatë vitit 2023, subjekt i hetimit penal nga IPK, kanë qenë gjithsej 178 persona (156 punonjës policor dhe 22 qytetar), shprehur në përqindje 1.8% e numrit të përgjithshëm të punonjësve policorë që janë hetuar nën dyshimin se janë përfshirë në veprimtari penale.



Viti 2023 konsiderohet një vit i suksesshëm për DH-në, bazuar në të dhënat lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, numrin e kallëzimeve penale, numrin e të arrestuarve, të suspenduarve etj.

Në vitin 2023, DH-ja ka pranuar 540 raste përmes DMA-së në kuadër të IPK-së, ndërsa 334 raste kanë vazhduar trajtimin nga vitet paraprake në vitin 2023, kurse D.H pas zhvillimit të hetimeve penale 2 raste i ka iniciuar për hetim disiplinore.


D.H ka trajtuar gjithsej 876 raste, duke përfshirë rastet e bartura nga vitet paraprake si dhe rastet e pranuar në këtë vit, të dhënat pasqyrohen në tabelën nr.6 si më poshtë.

Tabela nr.6 - Kategorizimi i rasteve dhe hapat procedural	
Gjithsej në punë	876
Të pranuar dhe regjistruara në vitin 2023	540
Në proces nga vitet paraprake	334
Rastet të iniciuara Disiplinore nga DH.	2

Totali prej 876 raste të trajtuara në vitin 2023 gjeneron si në vijim:

- 393 raste, nën hetim paraprak, në mungesë të elementeve të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm janë proceduar në DHB-PK për hetim të mëtutjeshëm administrativo - disiplinor;
- 184 raste janë parashtruar në Prokurorinë e Shtetit;
- 8 raste janë trajtuar në aspektin disiplinor administrativ⁵;
- 26 raste kanë mbetur në nivel informate të proceduar në DIA-DH;
- 22 raste janë bashkangjitur rasteve paraprake;
- 2 raste janë kthyer në PK për hetim të mëtutjeshëm bazuar në mandatin ligjor;
- 43 raste, pas zhvillimit të hetimeve paraprake janë mbyllur në Arkiv-IPK;
- 198 raste, kanë mbetur në proces që vazhdojnë trajtimin në vitin 2024 (171 nën hetim paraprak, 25 nën hetim penal dhe 2 nën hetim administrativ disiplinor).


Të gjitha të dhënat e lartcekura janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:



⁵ LIGJI Nr. 03/L-231, Neni 2, paragrafi 1.3, 1.4 dhe 14.5

IPK-DH gjatë vitit 2023, në Prokurorinë e Shtetit ka parashtruar 74 raste me Kallëzim Penal, 54 raste me Raport të Veçantë dhe 56 raste me Raport Informues (17 raste nën hetim penal dhe 39 raste në fazën e hetimit paraprak)⁶.

Bazuar në diagramin në vijim shihet se numri i kallëzimeve penale është në rënie të lehtë në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak, gjithashtu shihet një ngritje e dukshme e rasteve me raport të veçantë dhe me raport informues nga viti paraprak.




Si rezultat i proceseve hetimore dhe angazhimeve të personelit hetimor, gjithmonë kur janë plotësuar kushtet ligjore, DH-ja ka kryer arrestime të të dyshuarve për përfshirje në veprimtari penale, duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Republikës të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e parapara të Ligjit nr. 03/L-231, nenin 17, paragrafin 12, DH-ja kur konsideron se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e veprimit që mund përfshijë por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin e punonjësve policor.

IPK-ja në këtë periudhë raportuese, ka realizuar gjithsej 35 arrestime (21 punonjës të Policisë së Kosovës dhe 14 qytetarë) nën dyshimin e arsyeshëm se kanë qenë të përfshirë në veprimtari penale. IPK në vazhden e veprimeve hetimore ka rekomanduar 71 suspendime në interes të hetimit.

⁶ Duhet të kihet parasysh se Raportet Informuese parashtrohen edhe në fazën e hetimit paraprak me numër të DMA-së, për udhëzime të mëtutjeshme nga Prokurori i Shtetit.

Në diagramin në vijim janë paraqitur numri i zyrtarëve të arrestuar, suspenduar dhe transferuar për vitet 2021-2023.




Divizioni për Mbështetje Teknike pranë DH-së, në përmbushje të detyrave edhe përgjegjësi hetimore, ka mbështetur në kryerje të detyrave Divizionet tjera hetimore, duke qenë pjesë e punëve të tyre, konkretisht në 8 raste, të cilat kanë pasur të bëjnë me natyrën e masave të fshehta, atë të hetimit të veçantë në përmbushjen e urdhëresave të lëshuara nga Gjykatat kompetente.


Divizioni për Inteligjencë dhe Analizë pranë DH-së, në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në vitin 2023, ka trajtuar gjithsejtë 142 informata, ku 79 prej tyre kanë qenë të bartura nga viti paraprak, ndërsa ka arritur t'i procedoj 24 informata për hetim të mëtutjeshëm për Divizionet përkatëse në DH. Informata në proces dhe që vazhdojnë të trajtohen në vitin 2024 janë 118.

D.H në vazhden e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi, pas hetimeve paraprake ka proceduar për hetim penal 131 raste në vitin 2023, përderisa prej tyre në Prokurorinë e Shtetit ka parashtruar 113 raste, ndërsa 18 raste në proces vazhdojnë të trajtohen në vitin 2024.


Diagrami në vazhdim pasqyron statusin e rasteve penale të trajtuara dhe proceduara vetëm të vitit 2023, si dhe trendët e krahasuara me dy vitet paraqarre:



Duke ju referuar rasteve penale të trajtuara nga IPK në koordinim me Prokurorinë e Shtetit gjatë vitit 2023, në diagramin si në vijim janë pasqyruar 5 veprat penale më të shpeshta që janë hetuar gjatë vitit 2023:



Gjatë viteve të fundit (2021-2023) pothuajse të njëjtat vepra penale kanë prirë në listën e 5 veprave penale më të shpeshta, përjashtimisht vepra penale “Sulmi”, e cila në këtë vit raportues ka shënuar ngritje duke zëvendësuar veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik”. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” ka trend të uljes, ndërsa trendi tek veprat penale si “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”, “Lëndimi i lehtë trupor”, “Kanosja” dhe “Sulmi” këtë vit kanë shënuar ngritje.



Gjatë vitit 2023, DH ka qenë e përkushtuar në përbushjen e detyrave dhe përgjegjësive, në parandalimin dhe luftimin e veprimtarive penale të kryer nga punonjësit e Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të përfshirë me punonjësit e PK së, e me theks të veçantë në luftimin e veprimtarisë korruptive. Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare krahasuar edhe me dy vitet paraprake është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela nr. 7 - Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare				
Nr.	Lloji i veprës penale	2021	2022	2023
1	Keqpërdorimi pozitës po autoritetit zyrtar	27	39	24
2	Marrje e ryshfetit	01	06	01
3	Dhënie e ryshfetit	00	02	01
4	Ushtrim i ndikimit	02	03	00
5	Zbulimi fshehtësisë zyrtare	02	00	01
6	Falsifikim i dokumentit zyrtar	01	00	02
	Gjithsej	33	50	29

Tabela nr. 8 në vijim pasqyron të dhënat e veprave penale të trajtuara nga IPK gjatë vitit 2023, të ndara në kapituj duke ju referuar Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

Tabela nr. 8 - Lloji i veprave penale	Nr. i veprave
Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës (XIX)	
Neni 218 Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës	1
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (XIV)	
Neni 141 Nxitja e përçarjes dhe mos durimit	1
Veprat penale kundër jetës dhe trupit(XVI)	
Neni 172 Vrasja	1
Neni 177 Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje	1
Neni 181 Kanosja	16
Neni 182 Ngacmimi	4
Neni 183 Ngacmimi Seksual	1
Neni 184 Sulmi	11
Neni 185 Lëndimi i lehtë trupor	20
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut (XVII)	
Neni 195 Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike	22
Neni 202 Fotografimet dhe incizimet tjera të paautorizuar	2
Veprat penale kundër integriteti seksual (XX)	
Neni 227 Dhunimi	1
Veprat penale kundër martesës dhe familjes (XXI)	
Neni 248 Dhuna në familje	4
Veprat penale të narkotikëve (XXII)	
Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge	1
Neni 269 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge	3
Veprat penale kundër ekonomisë (XXV)	
Neni 294 Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm	1
Neni 296 Falsifikimi i parasë	3
Neni 301 Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit	1
Veprat penale kundër pasurisë (XXVI)	
Neni 321 Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë	1
Neni 323 Mashtrimi	1
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë (XXVIII)	
Neni 356 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	5
Neni 358 Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës	1
Veprat penale të armëve (XXVIX)	
Neni 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	1
Neni 367 Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	1
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik (XXX)	
Neni 370 Rrezikimi i trafikut publik	7

Neni 371 Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur	1
Neni 374 Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik	1
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (XXXI)	
Neni 378 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre	3
Neni 380 Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale	1
Neni 384 Deklarimet e rreme	1
Neni 386 Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare	1
Neni 387 Frikësimi gjatë procedurës penale	1
Neni 389 Manipulimi me prova	3
Neni 398 Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria	1
Veprat penale kundër rendit publik (XXXII)	
Neni 410 Vetëgjyqësia	1
Neni 401 Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare	2
Neni 402 Sulmi ndaj personit zyrtar	1
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (XXXIII)	
Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	24
Neni 421 Marrja e ryshfetit	1
Neni 422 Dhënia e Ryshfetit	1
Neni 426 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	1
Neni 427 Falsifikimi i dokumentit zyrtar	2

Policia e Kosovës ka gjithsej 8826 punonjës, nga të cilët 7958 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa 868 janë personel civil pa autorizime policore.

Në tabelat me numër 9 dhe 10 në vazhdim pasqyrohen të dhënat lidhur me 156 punonjësit policor dhe 22 qytetar të hetuar nga IPK-ja, ndarë sipas gradave të zyrtarëve që janë hetuar, si dhe krahasimi me dy vitet paraprake.

Të hetuarit sipas Gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Kadet	Shërbyes civil
	Numri i punonjësve	28	44	86	149	315	872	6464	0
Numri i të hetuarve	0	0	2	3	7	15	120	1	8

Tabela nr. 10 - Pasqyra e të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve ndër vitet 2021-2023

Të hetuarit sipas kategorive	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Kadet	Shërbyes civil	Qytetar
Viti 2021	0	2	3	2	6	19	172	0	9	//
Viti 2022	0	0	1	4	7	17	215	0	13	//
Viti 2023	0	0	2	3	7	15	120	1	8	22

Policia në bazë të strukturës organizative aktuale përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme dhe 7 Departamente, ku numrin më të madh të personelit prej 5199 punonjësve e ka Departamenti i Rendit Publik. Ky Departament përfshin 3 divizione (Divizioni i Policimit në Bashkësi, Divizioni i Trafikut Rrugor dhe Divizioni i Sigurisë Publike) dhe 14 Drejtori duke i përfshirë edhe DRP-të. Bazuar në këtë shpërndarje të personelit policor edhe numri më i madh i zyrtarëve të hetuar nga IPK-ja është pikërisht nga Departamenti i Rendit Publik.

Tabela në vazhdim pasqyron numrin e punonjësve policor të hetuar nga IPK-ja, të ndarë në strukturën organizative policore si Departamenti i Rendit Publik, Departamenti i Njësive Speciale, Departamenti i Kufirit, Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inteligjencës dhe Analizës, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse. Trendi i të hetuarve në të gjitha Departamentet ka ulje të numrit të punonjësve që kanë qenë subjekt hetimi në IPK, përjashtimisht Departamenti i Hetimeve ka një ngritje të lehtë.


Të gjitha të dhënat e lartpërmendura janë paraqitur në tabelën nr. 11 si në vijim:

Tabela nr. 11 - Pasqyra e numrit të punonjësve të hetuar sipas Departamenteve	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Departamenti i Rendit Publik	195	143	108
Departamenti i Njësive Speciale	///	///	11
Departamenti i Kufirit	17	97	24
Departamenti i Hetimeve	0	6	9
Departamenti i Inteligjencës dhe Analizës	///	///	1
Departamenti i Burimeve Njerëzore	0	1	1
Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse	0	10	2

Bazuar në atë se Departamenti i Rendit Publik përbëhet nga 3 divizione dhe 14 drejtori, të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë pasqyrën e shpërndarjes së 108 punonjësve policor të hetuar në Departamentin e Rendit Publik.

Pjesa dërmuese e të hetuarve është shpërndarë në Divizionin e Sigurisë Publike, ku janë strukturuar Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore.


Sipas të dhënave të IPK-së, vërehet një rënie e numrit të hetuarve për 24% krahasuar me vitin paraprak ose për 35 punonjës më pak. Të dhënat e lartcekura janë paraqitur në diagramin në vijim, ku shërbejnë punonjësit policor të hetuar.




Gjatë vitit 2023 janë hetuar 107 punonjës policor të angazhuar në drejtoritë rajonale, ku DRP - Prishtina prinë nga të gjitha drejtoritë me numrin më madh të hetuarve nga radhët e saj, duke pasur edhe numrin më të madh të punonjësve të shpërndarë në stacione policore.

Ngritje e numrit të hetuarve krahasuar me vitin paraprak ka shënuar DRP - Mitrovicë Jug, DRP - Ferizaj, DRP - Prizren dhe DRP - Gjakova, ndërsa ulje e numrit të hetuarve, ka shënuar DRP - Prishtina, DRP - Mitrovicë Veri, DRP - Gjilan dhe DRP - Pejë.

Diagrami në vazhdim paraqet pasqyrën e shpërndarjes së të hetuarve në 8 Drejtoritë Rajonale Policore.



Departamenti për Kufi, në organizimin e tij strukturor ka 2 divizione, 7 drejtori dhe Aeroportin e Prishtinës. Diagrami në vazhdim paraqet pasqyrën e shpërndarjes të 24 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar krahasuar edhe me dy vite paraprake.



Bazuar në fushëveprimin ligjor të IPK-së, sa i përket incidenteve të profilit të lartë dhe shkeljeve disiplinore të nivelit të lartë të menaxhimit dhe atyre të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2023, DH-ja ka trajtuar 10 raste (6 raste me të gjeturat e hetimit janë proceduar në DPP-PK, për procedim të mëtutjeshëm administrativ ndërsa pas zhvillimit të hetimeve disiplinore, 2 raste janë proceduar me rekomandim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës).

Tutje, në kuadër të fushë veprimtarisë dhe gjatë përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive në D.H, janë realizuar edhe shumë aktivitete tjera si zhvillimi i hetimeve proaktive me masa të fshehta hetimore, dalja në vend ngjarje, për incidentet të shkaktuar nga punonjësit policor e jo vetëm etj. Po ashtu në këtë periudhë kohore një pjesë e stafit të DH-së, kanë qenë të angazhuar në punë ekipore hetimore, ku janë realizuar edhe Planet Operative “Ulpiana” dhe “Transporti”.

D.H për vitin raportues, ka zhvilluar bashkëpunim të shkëlqyeshëm me të gjitha institucionet ligj zbatuese, si dhe bashkëpunime ndërkombëtare me institucione homologe.

7. INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE

Departamenti i Inspektimit në kuadër të IPK-së funksionon nga korriku i vitit 2006. Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Inspektimit është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese . Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore. Kjo mbikëqyrje arrihet duke realizuar inspektime (të rregullta e të jashtëzakonshme). Inspektimi nënkupton vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave nga PK-ja, duke siguruar arritjen e qëllimeve në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit janë: përgatitja e Planit Vjetor të Inspektimit në fushat e menaxhimit të përcaktuar me Ligjin për IPK-në; kryerja e inspektimeve me iniciativë të vetën, ose me urdhër të Ministrit; sigurimi i informatave nga fushat menaxheriale përmes metodave të autorizuar të marrjes dhe sigurimit të tyre; analizimi dhe vlerësimi i kryerjes së detyrave nga struktura policore; hartimi i raporteve të inspektimit bazuar në standardet e raportimit Qëllimi i çdo inspektimi është: që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, parimet dhe procedurat zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet; të përcaktojë nëse burimet shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj; që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e menaxhimit; të parandalojë shkeljet që mund të kryhen gjatë punës në fushë përkatëse; të identifikojë

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuar 13 inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtësore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluar qindra dosje administrative (penale, financiare, të prokurimit etj) dhe realizuar me dhjetëra intervista;
- Rekomanduam avansimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së 126 rekomandimeve;
- Verifikuar përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.
- Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë.

dobësitë - mangësitë dhe të rekomandojë masa për funksionimin më të mirë.

Inspektorët udhëhiqen nga një varg parimesh, përfshirë këtu profesionalizmin, objektivitetin, paanshmërinë politike dhe mosdiskriminimin. Inspektorët zhvillojnë aktivitetin e tyre në dy divizione: Divizionin për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, si dhe në Divizionin e Inspektimit dhe Raportimit. Departamenti i Inspektimit ka të angazhuar 10 punonjës me njohuri e aftësi të duhura në fushat e kontrollit policor që janë në kompetencë për inspektim. Gjatë vitit 2023, nga katër (4) trajnime të mbajtur kanë përfituar

njohuri 16 pjesëmarrës, në katër (4) punëtori kanë marrë pjesë katër (4) pjesëmarrës dhe gjashtë (6) pjesëmarrës kanë qenë pjesë e pesë (5) ekipeve të IPK-së, që kanë realizuar vizita studimore në Teksas (SHBA), Pragë (Çeki), Dublin (Irlandë) dhe Hagë (Holandë).

Raporti vjetor pasqyron se si Departamenti i Inspektimit ka kryer funksionin e tij ligjor për periudhën nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2023. Departamenti i Inspektimit përcjellë rregullin mbi raportimin e përvitshëm mbi aktivitetet nga fusha operationale, por edhe përfaqësimin dhe zhvillimin profesional. Viti 2023 ishte produktiv për Departamentin e Inspektimit, me gjithë sfidat që vështirësuan arritjen e objektivave tona. Falë angazhimit të inspektorëve janë realizuar 13 inspektime. Ky është tejkalim i pritjeve, kur merret parasysh se një vit më parë janë realizuar 12 sosh. Shihet një tejkalim i numrit të inspektimeve në masën prej 8.3% krahasuar me një vit më parë, që paraqet vitin më të suksesshëm në dhjetë (10) vitet e fundit. Inspektimet kanë rezultuar me 126 rekomandime. Departamenti përmbushë mandatin ligjor në përputhje me vlerat, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe të përqendruar në nevoja të përdoruesve të shërbimeve. Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë. Në përmbushje të misionit jemi të përkushtuar në zhvillimin e një policie të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale. Këto vlera do të forcojnë besimin e publikut në Policinë e vendit.

Përgjatë periudhës afatmesme kohore 2022 - 2024 jemi orientuar nga Strategjia e IPK-së dhe Plani i saj i Veprimit, nga i cili burojnë edhe planet vjetore të punës. Këto dokumente që

janë edhe në frymën e Programit qeveritar, inspektimin e shohin si mekanizëm të duhur në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit në radhët e punonjësve policor. Planet tona bazohen në analiza të risqeve të identifikuar dhe mbi bazën e tyre realizohen inspektime që trajtojnë fusha me interes, fusha këto që mund të prodhojnë efekte negative në zhvillimin e duhur policor. Lidhur me këtë, Departamenti ka kompetencën dhe përgatitjen për të kontrolluar mbarëvajtjen e proceseve brenda Policisë. Ne jemi të përkushtuar për përmirësimet e vazhdueshme profesionale, duke rishikuar kornizën inspektuese, politikat, procedurat tona, si dhe duke investuar në fuqinë tonë punëtore. Sa i përket kësaj të fundit, viteve të fundit kemi parasysh edhe profilizimin e personelit në fusha të caktuara, duke bërë që fushat inspektuese t'ua besojmë inspektorëve, varësisht prej afiniteteve të tyre. Për dallim nga vitet e kaluara, Departamenti i Inspektimit ka filluar të praktikojë edhe inspektime të shpejta në fusha të ngushta, duke gjeneruar raporte të shpejta. Inspektimi i stacioneve policore ka qenë po ashtu një risi në veprimtarinë tonë për të kuptuar performancën e disa prej tyre. Këto orientime do të na ndihmojnë të mbajmë rrugën e duhur për atë që duam të arrijmë. Ne do të rishikojmë strategjinë tonë për çdo vit për të siguruar që objektivat po na mbështesin për të përmbushur qëllimet për përmirësim të policimin në gjithë vendin. Nuk duhet harruar edhe rolin e partnerëve që vazhdojnë të mbështesin Departamentin me programe trajnimi për zhvillim profesional dhe vizita studimore jashtë vendit.

AKTIVITETET OPERATIVE BREND A PROCESIVE TË INSPEKTIMIT

Planifikimi /Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta

Në fillim të vitit, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka përmbyllur procesin e Planifikimit Vjetor të Inspektimeve, ku ka identifikuar fusha me risk dhe ka marrë parasysh politikat e realizimit të inspektimeve në baza të rregullta dy - tre vjeçare për fushat e njëjta. Me planet e tashme vjetore parashihen dhe inspektime në fusha të ngushta me raporte të shpejta. Departamenti u ka ofruar akterëve (Ministrisë, Policisë, IPK-së) të bëhen pjesë e procesit të planifikimit, për të siguruar një Plan cilësor, që adreson fushat me rëndësi dhe risk.

Siç parashihet në nenin 25 të Ligjit nr. 03/L-231 të IPK-së, brenda tremujorit të parë të vitit, Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimit i ka dorëzuar Kryeshefit Ekzekutiv, Planin Vjetor të Inspektimit. Ky autoritet me datë 23 janar 2023 ka miratuar Planin⁷, që ka marrë parasysh obligimet që dalin nga Strategjia, rëndësinë e programeve, risqet e identifikuara, rezultatet e inspektimeve të kaluar, kapacitetet njerëzore të Departamentit të Inspektimit dhe çështjet e pa trajtuara.

Plani Vjetor ka paraparë inspektime në fushat e menaxhimit, si në vijim:

- (a) Menaxhimi i ruajtjes dhe kontrollit të kufirit dhe migracionit;
- (b) Përbushja e rekomandimeve të IPK-së;
- (c) Vlerësimi i performancës së stacioneve policore;
- (d) Trajtimi i rasteve të dhunës në familje;
- (e) Trajtimi i rasteve të vjedhjeve;
- (f) Trajtimi i aksidenteve të trafikut;
- (g) Trajtimi i rasteve të trafikimit me narkotikë;
- (h) Trajtimi i rekomandimeve të dala nga hetimet disiplinore;
- (i) Sjellja policore në raport me qytetarët.

Për shkak të rritjes së kërkesave për inspektime të jashtëzakonshme, më 5 korrik 2023 është rishikuar Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta (2023), me çka ka ndryshuar agjenda inspektuese. Me rishikimin e këtij Plani janë përfshirë inspektimet, si:

- (a) Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Obiliqit,
- (b) Shqyrtimi i shkeljeve disiplinore dhe shqiptimi i masave nga KBD,
- (c) Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Klinës,
- (d) Trajtimi i rasteve të dhunës në familje,
- (e) Trajtimi i rasteve të vjedhjeve,
- (f) Ruajtja dhe kontrolli i kufirit dhe migracionit,
- (g) Përbushja e rekomandimeve të IPK-s

⁷ Plan Vjetor i Inspektimeve të Rregullta (2023), nr. 04-052-108, datë 24.01.2023.

Programet e punës inspektuese

Mbi bazën e Planit Vjetor të Inspektimeve janë nxjerrë Programet e punës inspektuese. Para se të hartohen Programet e tilla sipas kornizës kohore të përcaktuar, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka kryer para-studim të fushave përkatëse, duke synuar të njohë më mirë veprimtarinë policore, të studiojë planet, legjislacionin, organizimin, burimet policore, aktivitetet dhe raportet policore. Programet e punës janë hartuar nga Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, dhe janë propozuar nga Udhëheqësi i Departamentit. Ato më pas janë miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së. Janë përgatitur 13 Programe të punës inspektuese, (5 për inspektime të rregullta dhe 8 të tjera për inspektime të jashtëzakonshme). D.m.th janë iniciuar pesë (5) nga shtatë (7) inspektimet e planifikuara, që bashkë edhe me tetë (8) të tjera të jashtëzakonshme, kanë ngritur në gjithsej 13, numrin e inspektimeve të realizuara, si:

1. Menaxhimi i Fondit Emergjent të Policisë së Kosovës (i jashtëzakonshëm),
2. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Obiliqit (i rregullt),
3. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Gjakovës (i jashtëzakonshëm),
4. Shqyrtimi i lëndëve për shkelje disiplinore dhe shqiptimi i masave ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës nga KBD (i rregullt),
5. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Ferizajt (i jashtëzakonshëm),
6. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Klinës (i rregullt),
7. Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar (i rregullt),
8. Trajtimi i dhunës në familje nga Policia e Kosovës (i rregullt),
9. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Malishevës (i jashtëzakonshëm),
10. Menaxhimi i trafikut rrugor në Kryeqytet (i jashtëzakonshëm),
11. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Istogut (i jashtëzakonshëm),
12. Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Fushë Kosovës (i jashtëzakonshëm),
13. Vlerësimi i aktiviteve në parandalimin e garave të shpejtësisë me automjete (i jashtëzakonshëm).

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR INSPEKTIMET E REALIZUARA

Inspektimi nr. 01/2023:

Menaxhimi i Fondit të Fshehtë nga Policia e Kosovës

Me datën 10.01.2023, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka informuar IPK-në se për mbulimin e shpenzimeve gjatë operacioneve të veçanta policore për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror, Policia ka zhvilluar procedurat emergjente për furnizimin me pajisje policore, të paraparë me nenin 10 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 02/2021 për Menaxhimin dhe Shpenzimin e Fondeve të Veçanta Policore. Me këtë rast, i njëjti ka kërkuar që IPK-ja të zhvillojë inspektim në fushën e menaxhimit të procedurave lidhur me shpenzimin e këtij Fondi. Duke konsideruar se inspektimi është një instrument i suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv më 10.01.2023, ka kërkuar realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar menaxhimin e procedurave të shpenzimit të mjeteve të Fondit Emergjent. Objektivi i inspektimit ka qenë vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave në menaxhimin dhe shpenzimin e Fondit Emergjent. Inspektimi është realizuar në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të PK-së. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime dhe intervista me tre (3) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës përkatëse policore dhe janë kontrolluar njëzetë (20) dosje të prokurimit dhe të financave. Lidhur me këtë inspektim janë dhënë katër (4) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën përkatëse policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 02/2023

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Obiliqit

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta në vitin 2023 ka paraparë kryerjen e inspektimit në fushën e vlerësimit të performancës së Stacionit Policor të Obiliqit. Është hera e parë që IPK-ja zhvillon inspektime për stacionet policore veç e veç. Duke konsideruar se inspektimi është instrument i suksesshëm për të vlerësuar performancën e stacioneve, Kryeshefi Ekzekutiv më 21.02.2023 ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore të Stacionit. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet organizimi e angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin dhe luftimin e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) gjashtë drejtues dhe bartës të funksioneve të këtij Stacioni dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme. Janë dhënë 22 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 03/2023:

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Gjakovës

Më 14.04.2023, Kryeshefi Ekzekutiv e ka konsideruar të nevojshëm zhvillimin e një inspektimi në Stacionin Policor të Gjakovës. Në kërkesën e drejtuar në adresë të Departamentit të Inspektimit është kërkuar realizimi i një inspektimi të shpejtë e të thelluar në të gjitha funksionet e Stacionit. Inspektimi ka paraqitur interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë nëse Stacioni është duke realizuar objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e Stacionit, me fokus të veçantë në fushat: burime njerëzore, operative, hetime, shërbime administrative - mbështetëse. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin dhe luftimin e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) gjashtë drejtues dhe bartës të funksioneve të Stacionit dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme. Janë dhënë 15 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 04/2023:

Shqyrtimi i lëndëve për shkelje disiplinore dhe shqiptimi i masave ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor

Plani Vjetor i Inspektiveve të Rregullta në vitin 2023 ka paraparë kryerjen e inspektimit lidhur me hetimet disiplinore. Më herët, IPK ka kryer inspektim në DHBVK, autoritet ky brenda PK-së që kryen hetime disiplinore dhe rekomandon masa për shkelje disiplinore ndaj punonjësve policor. Kësaj radhe, IPK-ja ka pasur KBD-në si subjekt të inspektimit, i cili pranon lëndët nga DHBVK për shqyrtim disiplinor, me rekomandime për shqiptim të cilës do masë disiplinore dhe nga autoriteti hetues i nivelit lokal me rekomandim për shqiptim të cilësdo masë disiplinore për shkeljet e rënda disiplinore në kompetencë. Inspektimi ka qenë me interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit nëse KBD-ja realizon objektivat në përmbushje të mandatit. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet baza ligjore/organizimi dhe kapacitetet, të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave gjatë trajtimit të rekomandimeve të DSP-së dhe shqiptimit të masave disiplinore, të vlerësohet administrimi i dosjeve disiplinore, dhe të vlerësohet performanca e këtij Komisioni (përfshirë dhe identifikimin e masave të shqiptuar në raport me rekomandimet). Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me dy (2) drejtues dhe bartës të funksioneve të KBD-së dhe janë kontrolluar tridhjetë (30) dosje disiplinore. Janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 05/2023:

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Ferizajt

Me datën 26.05.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së e ka konsideruar të nevojshëm zhvillimin e një inspektimi në Stacionin Policor të Ferizajt. Në kërkesën e drejtuar në adresë të Departamentit të Inspektimit është kërkuar realizimi i një inspektimi të shpejtë e të thelluar në të gjitha funksionet e këtij Stacioni. Inspektimi ka paraqitur interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë nëse Stacioni është duke realizuar objektivat në përmbushje të mandatit ligjor për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e këtij Stacioni, me fokus të veçantë në fushat, si: burimet njerëzore, operative, hetime, shërbime administrative dhe mbështetëse. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin e luftimin e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve të këtij Stacioni dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme. Janë dhënë 12 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 06/2023:

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Klinës

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit për vitin 2023 ka përfshirë kryerjen e inspektimeve për të vlerësuar performancën dhe të stacioneve policore, përfshirë dhe atë të Klinës, në vazhden e monitorimit të angazhimeve policore të këtij niveli të organizimit. Ky inspektim ka qenë me rëndësi, me qëllim që të vlerësohet nëse Stacioni është duke realizuar me sukses objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët. Po ashtu, inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e këtij Stacioni, me fokus të veçantë në fushat, si: burimet njerëzore, operative, hetimet dhe shërbimet administrative dhe mbështetëse. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin e luftimin e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve të këtij Stacioni dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme. Janë dhënë 12 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 07/2023:

Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar

AMP dhe IPK kanë mandat që të kryejnë inspektime në Policinë e Shtetit Shqiptar dhe Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështet Policinë e të dyja vendeve për të siguruar shërbime profesionale, demokratike dhe të përgjegjshme policore. Dy agjencitë mbikëqyrëse me datë 13.09.2023 kanë shprehur gatishmëri të vlerësojnë përmbushjen e detyrave nga policinë e dy vendeve sa i përket zbatimit të marrëveshjeve dhe protokolleve të arritura nga qeveritë e të dyja vendeve. Inspektimi i ka kontribuar ngritjes së cilësisë së shërbimeve policore në drejtim të menaxhimit efektiv dhe efikas të kontrollit kufitar. Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm (23.03.2015), si dhe në përputhje edhe me Programin e Punës Inspektuese të miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i AMP-së, strukturat e inspektimit të të dyja agjencive respektive kanë zhvilluar një inspektim të përbashkët. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohet efikasiteti i policive kufitare lidhur me kontrollin kufitar, të vlerësohen aktivitetet policore në parandalimin dhe luftimin e krimit, të vlerësohen kapacitetet infrastrukturore dhe logjistike/kushtet e sigurisë dhe të punës. Inspektimi është përqendruar në strukturat përkatëse policore të dy vendeve konkretisht në PPKK: Morinë - Vermicë, Qafë Prush - Gjakovë dhe Qafë Morinë - Gjakovë. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve të PPKK të PK-së dhe Policisë së Shtetit dhe është inspektuar infrastruktura e objekteve të PPKK-ve ku kryhet kontrolli kufitar, si dhe pajisjet logjistike që përdoren nga punonjësit e policive respektive në kuadër të kryerjes së veprimeve të përbashkëta policore. Nga ky inspektim i përbashkët janë dhënë 10 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve.

Inspektimi nr. 08/2023

Trajtimi i dhunës në familje nga Policia e Kosovës

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta për vitin 2023 ka përfshirë kryerjen e inspektimit në fushën e trajtimit policor të dhunës në familje. Inspektimi i kësaj fushe të ndjeshme ka qenë me interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësohet nëse PK në të gjitha nivelet e organizimit të saj është duke përmbushur objektivat në përmbushje të mandatit dhe obligimeve që dalin nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e njërive patrulluese dhe hetimore në trajtimin me sukses të veprave penale të kësaj natyre. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohen kapacitetet për trajtimin e rasteve, të vlerësohet reagimi policor dhe hetimi i rasteve, të vlerësohen aktivitetet policore në monitorimin e urdhrave mbrojtës, si dhe të vlerësohet përmbajtja e dosjeve dhe evidencave. Inspektimi është përqendruar në Divizionin e Policimit në Bashkësi dhe në sektorët hetimor të 14 stacioneve policore (Fushë Kosovë, Graçanicë, Gjilan, Klllokot, Pejë, Junik, Mitrovicë Jugu, Vushtrri, Malishevë, Rahovec, Prizren, Prizren Veriu, Kaçanik dhe Hani i Elezit). Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me 15 drejtues dhe bartës të funksioneve të stacioneve dhe janë kontrolluar 30 dosje penale të rasteve të dhunës në familje. Janë dhënë nëntë (9) rekomandime, që u atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 09/2023

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Malishevës

Në vazhden e monitorimit të angazhimeve në të gjitha nivelet e organizimit policor, me datën 24.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së e ka konsideruar të nevojshëm zhvillimin e inspektimit për të vlerësuar performancën e Stacionit Policor të Malishevës. Në kërkesën e cila i është drejtuar Departamentit të Inspektimit është kërkuar realizimi i një inspektimi për të verifikuar zbatimin e procedurave të parapara dhe nivelin e performancës të Stacionit në fjalë. Inspektimi ka paraqitur interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë nëse ky Stacion është duke realizuar me sukses objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e Stacionit, me fokus në fushat: burime njerëzore, operative, hetime, shërbime administrative dhe mbështetëse. Objektivat e inspektimit kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin e luftimin e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues e bartës të funksioneve të Stacionit, si dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme. Janë dhënë 16 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 10/2023

Menaxhimi i trafikut rrugor në Kryeqytet

Me datë 30.08.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka autorizuar inspektim të jashtëzakonshëm për të vlerësuar rolin policor në ofrimin e shërbimeve cilësore të policimit gjatë menaxhimit të trafikut në Kryeqytet. Inicimi ka ardhur si rezultat i informatave të pranuar mbi gjendjen shqetësuese të trafikut rrugor të qytetit dhe shkeljen e rregullave nga ana e qytetarëve. Sipas këtyre informatave, shqetësuese është shkelja e rregullave të trafikut në disa zona të qytetit, si rezultat i ndaljes dhe parkimit vend e pavend të mjeteve. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohet organizimi e angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në përmirësimin e gjendjes në trafikun rrugor dhe ngritjen e nivelit të sigurisë rrugore, të vlerësohet performanca policore lidhur me menaxhimin e trafikut rrugor, si dhe të identifikohen vështirësitë që sfidojnë qarkullimin e duhur të njerëzve dhe mjeteve. Inspektimi është përqendruar në stacionet policore të Prishtinës (Qendër, Jugu dhe Veriu), si dhe Njësinë e Trafikut të Kryeqytetit. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me katër (4) drejtues e bartës të funksioneve të stacioneve. Janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 11/2023

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Istogut

Në vazhden e monitorimit të angazhimeve në të gjitha nivelet e organizimit policor, me datën 24.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së e ka konsideruar të nevojshëm zhvillimin e inspektimit për të vlerësuar performancën e Stacionit Policor në Istog. Në kërkesën që i është drejtuar Departamentit të Inspektimit është kërkuar realizimi i inspektimit për të verifikuar zbatimin e procedurave të parapara dhe nivelin e performancës të Stacionit në fjalë. Inspektimi ka paraqitur interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit nëse ky Stacion është duke realizuar me sukses objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e këtij Stacioni, me fokus në fushat: burimet njerëzore, operative, hetime, shërbime administrative dhe mbështetëse. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohet organizimi e angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin e luftimin e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve të Stacionit dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme. Janë dhënë gjithsej 14 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 12/2023

Vlerësimi i performancës së Stacionit Policor të Fushë Kosovës

Në vazhden e monitorimit të angazhimeve në të gjitha nivelet e organizimit policor, me datën 24.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së e ka konsideruar të nevojshëm zhvillimin e inspektimit për të vlerësuar performancën e Stacionit Policor në Fushë Kosovë. Në kërkesën që i është drejtuar Departamentit të Inspektimit është kërkuar realizimi i inspektimit për të verifikuar zbatimin e procedurave të parapara dhe nivelin e performancës të Stacionit në fjalë. Inspektimi ka paraqitur interes për IPK-në, me qëllim të vlerësimit nëse ky Stacion është duke realizuar me sukses objektivat në përmbushje të mandatit ligjor, për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me performancën e këtij Stacioni, me fokus në fushat: burimet njerëzore, operative, hetime, shërbime administrative dhe mbështetëse. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohet organizimi e angazhimi i burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, të vlerësohen aktivitetet hetimore në parandalimin e luftimit e krimit, dhe të vlerësohen kapacitetet teknike dhe kushtet e punës. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve të Stacionit dhe janë kontrolluar 81 dosje të ndryshme.

Inspektimi nr. 13/2023

Vlerësimi i aktiviteteve në parandalimin e garave të shpejtësisë me automjete

Me datë 20.12.2023, Kryeshefi Ekzekutiv ka autorizuar fillimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave nga struktura përkatëse policore në parandalimin e organizimit të garave ilegale të shpejtësisë me automjete, si dukuri e shpeshtë, shqetësuese dhe e rrezikshme për sigurinë rrugore. Inicimi ka ardhur si rezultat i informacioneve të mbledhura mbi organizimin dhe zhvillimin e garave ilegale me automjete, që ka kulmuar me incidentin me tre viktima në Autostradën "Ibrahim Rugova" në afërsi të Prizrenit. Ky inspektim ka ofruar një mundësi për të vlerësuar mobilizimin dhe përkushtimin policor në adresimin e kësaj dukurie, që rrezikon sigurinë rrugore. Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë që të vlerësohet organizimi dhe kapacitetet policore (njerëzore dhe teknike), të vlerësohen aktivitetet policore në parandalimin e garave të shpejtësisë, si dhe të vlerësohen masat e ndërmarra në ngritjen e sigurisë rrugore. Inspektimi është përqendruar në NJRTR- Prizren, NJKA dhe në stacionet policore në Prizren dhe Prizren Veriu. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me katër (4) drejtues dhe bartës të funksioneve, si dhe janë kryer verifikime të zonave specifike ku janë organizuar gara të tilla të shpejtësisë me automjete dhe lokacioneve apo prezencës së patrullave policore.

8. PLANIFIKIMI STRATEGJIK, ÇËSHTJET LIGJORE, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI

Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim (DPBÇLI) është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon nga viti 2017.

Përgjegjësitë (detyrat) e këtij Departamenti janë:

- udhëheqë aktivitetet në nxjerrjen e planeve strategjike, bazuar në objektivat strategjike të Ministrisë, si dhe vlerëson zbatimin e planeve për përmbushjen e objektivave strategjike;
- siguron shërbime juridike/këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale;
- udhëheqë aktivitetet për nxjerrjen, rishikimin- plotësimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe PSO-ve lidhur me funksionet e IPK-së;
- udhëheqë me aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit e partneritetit ndër institucional brenda dhe jashtë vendit;
- udhëheqë aktivitetet e organizatës në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushë komunikimit dhe informimit publik;
- udhëheqë me aktivitetet për të siguruar realizimin e politikave në promovimin e vlerave, me qëllim të ngritjes së besimit dhe fuqizimit të rolit mbikëqyrës të IPK-së.

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM, BASHKËPUNIM, ÇËSHTJE LIGJORE DHE INFORMIM

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi 60 komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi 180 kërkesa të tyre;
- Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore etj.

DPBÇLI zhvillon aktivitetin në dy (2) divizione:

- Divizionin për Planifikim dhe Çështje Ligjore;
- Divizionin për Bashkëpunim dhe Informim.

Departamenti ka të punësuar gjashtë (6) punonjës.

IPK-ja gjatë vitit 2023 është angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga Plani Zhvillimor Strategjik 2022 - 2024 dhe detyra të tjera sipas nevojave. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimit vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes DPBÇLI-së.

DPBÇLI është angazhuar në aspektin e planifikimit strategjik duke përgatitur Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së Analizës së Riskut për IPK-në, finalizimin e PSO-ve etj. Angazhimet e DPBÇLI-së janë fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, institucione vendore dhe ndërkombëtare.

a) Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të bashkëpunimit vendor, DPBÇLI kanë pasur aktivitete me rëndësi në fuqizimin e këtij bashkëpunimi. Si pikë e kontaktit me institucionet vendore, janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera, janë kthyer përgjigjet në MPB mbi raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë. DPBÇLI ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe ka raportuar mbi numrin e kërkesave të trajtuara.



Në kuadër të angazhimeve me institucionet e tjera, është ngritur niveli i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për fushën e të drejtave e lirive të njeriut. DPBÇLI ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga ky institucion, respektivisht nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti kanë fuqizuar

bashkëpunimin me Prokurorin e Shtetit në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera të penale. Kjo ka ndikuar që IPK dhe Prokuroria e Shtetit zhvillojnë raporte të bashkëpunimit në luftimin e dukurive negative, të cilat hasen në Polici, e në veçanti në luftimin e korrupsionit, përmes shkëmbimit të informatave dhe trajtimit të tyre mbi dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor.

Bashkëpunimi me Policinë është i orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse.

Gjatë vitit 2023 Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Kushtrim Hodaj dhe z. Kastriot Jashari, zv. Drejtor i Përgjithshëm i AKSP-së kanë nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit ndërmjet IPK-së dhe AKSP-së.



Kjo marrëveshje u nënshkrua më qëllim të arritjes së objektivave të përbashkëta strategjike të Akademisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës në fushën e trajnimeve dhe ngritjen e cilësisë në zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Marrëveshja përveç tjerash përfshinë bashkëpunimin reciprok në mes Inspektoratit Policor të Kosovës dhe AKSP-së për angazhim të stafit trajnues nga IPK në fushën e trajnimeve.

b) Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun

Varësisht sipas nevojave operative në terren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit nga DPBÇLI në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë kanë qenë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media;
- dhënia e deklaratave për mediet;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së
- Kërkesat për qasje në dokumente publike etj.
- Përgatitja e Planit vjetor të IPK-së.

Në kuadër të këtyre angazhimeve janë trajtuar me qindra kërkesa përmes telefonatave të ndryshme nga mediat, mbi 180 kërkesa me shkrim të adresuara në adresën zyrtare të Divizionit për bashkëpunim dhe informim (DBI) si dhe janë publikuar më shumë se 60 komunikata për medie lidhur me aktivitetet e ndryshme të IPK-së.

Përveç këtyre angazhimeve ky Divizion ka përgatitur në baza të rregullta analizën – raportin e shtypit ditor lidhur me ngjarjet që janë mbuluar nga mediat dhe i cili është shpërndarë te zyrtarët e IPK-së.

DBI ka administruar dhe ka përditësuar edhe rrjetet sociale me fokus të veçantë në Facebook-un zyrtar. Secila komunikatë e cila është përcjellë për publikim në ueb faqen zyrtare është publikuar edhe në Facebook duke rritur në këtë mënyrë edhe numrin e ndjekësve në këtë rrjet social.

Publikimi i revistës “Integriteti” dhe buletinit mujor “Linja e Kaltër”



Ndër angazhimet e IPK-së në vitin 2023 për fuqizim të transparencës ka qenë edhe publikimi i revistës së rregullt “Integriteti”. Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, kjo revistë konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve policor, partnerëve dhe qytetarëve për angazhimet e IPK-së.

Përveç revistës “Integriteti” në vitin 2023 IPK respektivisht Divizioni për bashkëpunim dhe informim ka vazhduar me projektin që i referohet fuqizimit të transparencës së brendshme duke publikuar çdo muaj buletinin e titulluar “Linja e Kaltër”.

c) Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me ICITAP-in



IPK-ja çmon lartë bashkëpunimin me ICITAP-in, i cili është i rëndësishëm së veçantë. ICITAP ka ndihmuar IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Trajnimet që ka ofruar ICITAP-i ndër vite, kanë qenë mëse të nevojshme për IPK-në dhe të duhura për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK është përkrahur me trajnime specifike që kanë fuqizuar kapacitetet profesionale.

IPK në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan ka organizuar në Prizren Konferencën Rajonale tre ditore me temën “Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit në policinë kufitare”.


Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin zyrtarë të lartë nga institucionet homologe të mbikëqyrjes policore të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut si dhe zyrtarë të lartë nga MPB-ja, Prokuroria e Shtetit, PK-ja, etj.

Gjatë konferencës u diskutua për sfidat në luftimin e korrupsionit tek policia kufitare, praktikat e mira të parandalimit dhe luftimit të këtij fenomeni duke prezantuar edhe disa raste studimi të operacioneve të suksesshme përfshirë këtu edhe operacionin “Pika 1 dhe 2” të IPK-së dhe raste nga vendet e rajonit.



Ndër temat e trajtuara ishin edhe ato që ndërlidhen me fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve të kontrollit të brendshëm të vendeve të rajonit lidhur me përgjegjshmërinë dhe integritetin e policisë kufitare etj.

Në ceremoninë e mbajtur në muajin prill të këtij viti në Departamentin e Shtetit në Washington për ditën e Akademisë Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit (ILEA), Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së



Kushtrim Hodaj është për zgjedhur fitues i çmimit kryesor për Sukses të Jashtëzakonshëm Operacional, si i nominuar për realizimin me sukses operacionit antikorrupsion të IPK-së ku u arrestuan 74 zyrtarë policorë në operacionin e vitit të kaluar të koduar me emrin “PIKA 1 dhe PIKA 2”.

Në këtë ceremoni ishin të nominuar zyrtarë nga 52 shtete nga e gjithë bota, ndërkaq çmimi u nda nga Nënsekretarja e Shtetit znj. Uzra Zeya dhe Ndihmës Sekretari i INL-it (Byroja për Çështje të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit) z. Todd Robinson.

Në ceremoninë e organizuar për 17 vjetorin e themelimit të IPK-së u nënshkrua Deklarata për themelimin e **Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore**, nga udhëheqësit e agjencive homologe nga katër shtetet (Republikës së Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi).

Themelimi i Forumit Rajonal vjen pas konferencës rajonale së mbajtur në Prizren këtë vit ku një prej konkluzioneve ishte ai për themelimin e forumit të përbashkët të agjencive të mbikëqyrjes/kontrollit policor të Republikës së Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Me përkrahjen e ICITAP-it, Kryeshefi i IPK-së Kushtrim Hodaj me bashkëpunëtorë dhe zyrtarë të ICITAP-it Amerikan në Kosovë, përfshirë Atasheun e DoJ ICITAP në



Ambasadën Amerikane znj. Kimberly Riffe, morën pjesë në konferencën vjetore të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Fort Worth, Texas të SHBA-ve.

Gjatë punimeve të konferencës u diskutua për sfidat e mbikëqyrjes policore dhe rëndësinë e shkëmbimit të përvojave nga agjencitë homologe.



Bashkëpunimi me OSBE-në

Misioni i OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 2022 ka ofruar përkrahje për IPK-në me trajnime të specializuara dhe aktivitete të ndryshme. DBI në bashkëpunim me misionin e OSBE-së (Sektorit për Zhvillim dhe Monitorim të Policisë) ka marrë pjesë si panelist në disa punëtori të organizuara në muajin gusht, shtator dhe tetor në Prishtinë, Pejë, Gjiçan, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut me titullin “Baza ligjore mbi përdorimin forcës dhe mjeteve të përdorimit të forcës, trajnimi dhe trajtimi i të drejtës ankuese të qytetarëve në Policinë e Kosovës”

Punëtoritë kanë mbledhë së bashku bashkëpunëtor policor dhe prokurorë për të



diskutuar konceptin e përdorimit të forcës proporcionale, autorizimet policore, dhe procedurat ligjore që rregullojnë këto aspekte. Qëllimi kryesor ishte të fuqizohet të kuptuarit e policisë mbi të drejtat e tyre ligjore dhe kufizimet me qëllim të parandalimit të incidenteve të pajustificuara të përdorimit të forcës dhe abuzimi i autorizimeve policore.

Bashkëpunimi me EPAC-un

Përfaqësuesit e IPK-së morën pjesë në konferencën vjetore të EPAC-ut dhe Asamblesë së Përgjithshme e cila u mbajt në Dublin të Irlandës.

Në konferencë pjesëmarrës ishin edhe delegacione të ndryshme të agjencive të mbikëqyrjes policore dhe agjencive kundër korrupsionit.

Gjatë punimeve të konferencës janë zhvilluar diskutime në sesione të ndara duke përfshirë trajtimin e temave nga fusha si: trajtimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve, aktivitetet anti korrupsion, risitë në hetimin e korrupsionit dhe mbikëqyrjes policore.

Gjithashtu, një delegacion i IPK-së mori pjesë në një punëtori mbresëlënëse dhe të përshtatur me kujdes nga Autoriteti Holandez për Sinjalizues në kuadër të programit EPAC/EACN. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve së bashku edhe me delegacionet nga Sllovenia dhe Lituania.



Bashkëpunimi me AMP

Edhe këtë vit ka pasur shumë aktivitete të përbashkëta ndërmjet IPK-së dhe AMP-së të cilat aktivitete dhe bashkëpunime janë vlerësuar lartë nga Inspektorati Policor. Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm të AMP-së në vazhden e bashkëpunimit të ndërsjellë të të dy agjencive homologe të mbikëqyrjes policore nënshkruan Raportin nga inspektimi i përbashkët, i cili është realizuar nga strukturat inspektuese të të dyja agjencive, në fushën "Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për



ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar". Zyrtarët e IPK-së këtë vit morën pjesë edhe në Konferencën – punëtorinë dy ditore në Tiranë të organizuar nga AMP në bashkëpunim me CIDS-in norvegjez (Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes) .

9. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMET E PËRGJITHSHME

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (DFSHP) ka rol mbështetës në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore, sistemeve të Teknologjisë Informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DFSHP-së janë: menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore të IPK- së, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative, siguron zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të IPK-së, koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të IPK-së, menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të IPK-së, ofron shërbime logjistike për IPK-në, menaxhon, administron, mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së.

DFSHP ka të punësuar 18 punonjës dhe është i strukturuar në tre divizione:

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore; dhe
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike.

DFSHP ka ofruar këto shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhimin e buxhetit të ndarë i cili është realizuar 96.18 %;
- Menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Teknologjisë Informative;
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së;
- Realizimin e Planit të dalë nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së.

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

Ofruam shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

Menaxhuam buxhetin e ndarë dhe realizuam 96.18 % të tij;

Vazhduam ndërlidhjen e data bazave me Policinë e Kosovës dhe ARC-në;

Organizuar trajnime bazuar në Strategjinë e Trajnimeve të IPK-së;

Realizuar projektin Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së me zhvillimin e sistemit SEMA.

Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së

Misioni kryesor DFSHP-së është menaxhimi i drejtë, efikas dhe me nikoqirllëk me parat publike për nevojat e IPK-së, në pajtueshmëri të plotë me Ligjin me Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194, si dhe me rregulloret dhe udhëzimet administrative financiare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të arritjes së misionit dhe objektivave të parapara të IPK-së.

Tabela me të dhënat finale të buxhetit dhe shpenzimeve

Nr.	Kategoria ekonomike	Buxheti final SIMFK	Shpenzimet	Mbetja	% e realizimit
1	Pagat dhe shtesat	997,522.32	991,333.62	6,188.70	99.38
2	Mallra e shërbime	368,898.00	336,896.50	32,001.50	91.33
3	Shpenzime komunale	13,010.00	3,652.11	9,357.89	28.07
4	Projekte kapitale	41,650.00	34,950.68	6,699.32	83.92
Gjithsej:		1,421,080.32	1,366,832.91	54,247.41	96.18

DFSHP ka bërë menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së, ku aktualisht i posedon pesëdhjetë (50) vetura zyrtare. Prej tyre, katër dhjetë (40) vetura zyrtare ose tetëdhjetë për qind (80%) e tyre janë vetura të cilat përdoren aktivisht nga punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës. Ndërsa dhjetë vetura zyrtare të tjera ose njëzet për qind (20%) e tyre janë vetura të cilat janë jashtë përdorimit në IPK.

Gjithashtu, DTISHL/DFSHP ka bërë menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së, ku në vazhdimësi ka trajtuar kërkesat për servisimin e automjeteve, ka hartuar autorizimet, si dhe ka bërë sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve, inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të flotës dhe po ashtu ka vazhduar të mbaj të dhënat në kartelë fizike dhe elektronike mbi gjendjen e secilit automjet të IPK-së.

Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike në kuadër të DFSHP-së ka përfunduar me sukses fazën e tretë të projektit kapital “*Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së*”, ku përmes këtij projekti është zhvilluar Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Arkivës – i quajtur **SEMA**. Me përdorimin e tij, të gjitha lëndët e arkivit të IPK-së në formë elektronike do të futen edhe në këtë sistem, ku qasja në dokumentet e arkivit si për zyrtarin e arkivit e po ashtu edhe për të gjithë stafin e IPK-së do të jetë më e shpejtë dhe më e lehtë.

IPK çdo herë i ka kushtuar rëndësi të veçantë ndërtimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të saj përmes trajnimeve të ndryshme. Edhe këtë vit ka vazhduar përkrahja e fuqishme e ICITAP-it dhe Ambasadës Amerikane në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të IPK-së përmes trajnimeve dhe vizitave studimore në SHBA. Krahas ICITAP-it, IPK ka pranuar përkrahje në fushën e trajnimit edhe nga Misioni i OSBE-së në fusha të rëndësishme për realizimin e misionit ligjor të saj.

IPK falënderon partnerët ndërkombëtar dhe ata vendor (AKSP dhe IKAP) për përkrahjen e vazhdueshme drejt fuqizimit të kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të saj. Tabelat në vijim prezantojnë numrin e trajnimeve dhe pjesëmarrësve në trajnimet për stafin operativ dhe atij administrativ të IPK-së.

TRAJNIMET/ PUNONJËSIT OPERATIV- 2023										
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Datat	Muaji	Ditët	Pjesëmarrës	Një ditë e trajnimit kthyer	Gjithsej orë/për një pjesëmarrës	Gjithsej orë/për gjithë	Mesatarja e orëve të trajnimit për
1	Krimi i Organizuar Transnacional	CTOC	14.02.2023	Shkurt	18	2	8	144	288	4.17
			09.03.2023	Mars			0	0	0	-
			17.04.2023	Prill	20	1	8	160	160	2.32
			13.05.2023	Maj			0	0	0	-
2	Anticorruption and model Law Executive Policy and Development Symposium	ICITAP	23.01.2023	Janar	10	1	8	80	80	1.16
			03.02.2023	Shkurt			0	0	0	-
3	Undercover operations Cours	ICITAP	06-10.2023	Shkurt	5	2	8	40	80	1.16
4	Justice vis-à-vis personal data protection	AIP	21.02.2023	Shkurt	16	2	8	128	256	3.71
			15.03.2023	Mars			0	0	0	-
5	Transparency and Accountability in Government I	ICITAP	20.07.2023	Mars	15	1	8	120	120	1.74
			07.04.2023	Prill			0	0	0	-
6	Ngasja Emergjente	AKSP	13-20.2023	Prill	6	1	8	48	48	0.70
7	Trajnimi i Avancuar për mbrotjen e deshmitarëve dhe sinjalizueseve	ICITAP	22-26.2023	Maj	5	12	8	40	480	6.96
8	Luftimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës në baza gjinore	AKSP	23.05.2023	Maj	1	1	8	8	8	0.12
			13.06.2023	Qershor	1	1	8	8	8	0.12
9	Siguria Kibernetike	ICITAP	22-26.2023	Maj	5	1	8	40	40	0.58
10	Training on Artificial Intelligence and strategic communication	OSCE	26-28.2023	Maj	3	2	8	24	48	0.70
11	Menaxhimi i situatave të de-eskalimit	ICITAP	12-13.2023	Qershor	2	20	8	16	320	4.64
			20-21.2023	Qershor	2	19	8	16	304	4.41
12	Vlerësimi i Rrezikut në rastet e Dhunës në Familje	OSCE	17-21.2023	Korrik	5	2	8	40	80	1.16
			28.08.2023	Gusht-Shtator	49	5	8	392	1960	28.41
09.11.2023	Tetor-Nëntor	0	0	0			-			
14	Attanded the National Internal Affairs Investigators Association- Conference held Inf Fort Wort, Texas	ICITAP	28-31.2023	Gusht	4	4	8	32	128	1.86
15	Trajnimi i avancuar për trajtimin e informatave	OSCE	04-08.2023	Shator	5	10	8	40	400	5.80
16	Ndërgjegjësimi, parandalimi dhe luftimi i korrupsionit	AKSP	20-24.2023	Nëntor	5	3	8	40	120	1.74
17	Qasja ndaj dhunës në baza gjinore	AKSP	29-01.2023	Nëntor Dhjetor	3	3	8	24	72	1.04
18	Të Drejtat e Njeriut	AKSP	21.2023	Dhjetor	1	4	8	8	32	0.46
Totali					181	97				

TRAJNIMET/ PUNONJËSIT ADMINISTRATIV- 2023

Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Datat	Muaji	Ditët	Pjesëmarrës	Një ditë e trajnimit kthyer	Gjithsej orë për një pjesëmarrës	Gjithsej orë për gjithë	Mesatarja e orëve të trajnimit për
1	Bashkimi Evropian, Institucionet dhe roli i tij	IKAP	09-10.2023	Shkurt	2	1	8	16	16	0.80
2	Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike	IKAP	16-17.2023	Mars	2	1	8	16	16	0.80
3	Procesi i rekrutimit në bazë të meritës	MBR	23.03.2023	Mars	1	1	8	8	8	0.40
4	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore	IKAP	28-29.2023	Mars	2	1	8	16	16	0.80
5	Menaxhimi i Kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktorëve	ICITAP	29.03.2023	Mars	1	4	8	8	32	1.60
6	Pranimi dhe karriera në Shërbimin Civil	IKAP	13-14.2023	Prill	2	1	8	16	16	0.80
7	Procedura e Përgjithshme Administrative	IKAP	3-4.2023	Prill	2	1	8	16	16	0.80
8	Dispozitat themelore për rregullimin e ndihmës shtatore	IKAP	27-28.2023	Prill	2	1	8	16	16	0.80
9	Plani Kontabël dhe Kontabiliteti në SIMFK	IKAP	11-12.2023	Maj	2	1	8	16	16	0.80
10	Menaxhimi dhe monitorimi i projektit	IKAP	15-17.2023	Maj	3	1	8	24	24	1.20
11	Vlerësimi i ndikimit buxhetor të nismave të reja Qeveritare	IKAP	15-18-2023	Maj	4	1	8	0	0	0
12	Parimet e Avancuara të Rekrutimeve të Bazuara në Meritë	IKAP/MBR	11-12.2023	Maj	2	1	8	16	16	0.80
13	Përshkrimi, Vlerësimi dhe Klasifikimi i Pozitave të Punës në Shërbimin Civil	IKAP	20-21	Qershor	2	1	8	16	16	0.80
14	Menaxhim dhe udhëheqje stafi komandues	ICITAP	28.08.2023	Gusht Shtator Tetor Nëntor	49	1	8	392	392	5.68
			09.11.2023				0	0	0	0
15	Planifikimi i objektivave vjetore të nëpunësve civilë dhe harmonizimi i tyre me objektivat e institucionit.	IKAP	28.09.2023	Shtator	1	1	8	8	8	0.40
16	Ngritja e kapacitete administrative ne mbrojtjen e te dhënave personale dhe siguria kibernetike	EIPA	19-20.2023	Shtator	2	1	8	16	16	0.80
17	Përdorimi i softuerit administrator për arkiv	PBC	11.12.2023	Dhjetor	1	1	8	8	8	0.40
Totali					80	20				



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR 2023



**INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO**

**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**📞 | 08003333 | RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**

**SË BASHKU PËR NJË POLICI PROFESIONALE
ZAJEDNO ZA PROFESIONALNU POLICIJU
TOGETHER FOR PROFESSIONAL POLICE**

**IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION**